



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 99/2023

Datë: 17/08/2023

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7/01 Mars 2019), duke u bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe nenin 12 të Rregullores MF 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve, Sekretarja e Përgjithshme, nxjerr:

VENDIM

Thirrje publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Autorizohet shpallja e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.
2. Thirrja publike nga pika 1 e këtij Vendimi bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullorës MF 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, kodi ekonomik 21200, kategoria e shpenzimeve, subvencione dhe transfere në kuadër të nën programit buxhetor 01500.
4. Mjetet e përcaktuara në pikën 3 të këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve dhe dokumentacionit përkatës për zbatimin e thirrjes.
5. Dokumentacioni përkatës i nevojshëm dhe kriteret për aplikim për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale

dhe familjare, do të publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë (<https://md.rks-gov.net>).

6. Në përputhje me Rregulloren MF 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Udhëzuesit për aplikantët, Ministria e Drejtësisë do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara sipas thirrjes publike.
7. Komisioni Vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses apo jo kushtet për të qenë pjesë e konkurrimit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
8. Anëtarëve të Komisionit Vlerësues u takon kompensimi për punën e kryer në komision sipas legjislacionit përkatës për punë jashtë orarit.
9. Zyrtari Kryesor Administrativ merr Vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve të OJQ-ve pas pranimit të Vendimit të Komisionit Vlerësues për aplikuesit e suksesshëm.
10. Ministria e Drejtësisë do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave dhe do të bëjë transferin e mjeteve financiare tek përfituesit, përkatësisht OJQ-të.
11. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është njësia përkatëse që mbulon fushat në bazë të thirrjes publike të shpallur nga Ministria e Drejtësisë.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Anita Kalanderi
Sekretare e Përgjithshme



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Divizionit për Shërbime Sociale;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Br. ___/2023

Datum: ___/___/2023

Na osnovu člana 18. Zakona br. 06/L-113 o Organizaciji i Funkcionisanju Državne Uprave i Nezavisnih Agencija, (Službeni list Republike Kosovo / br. 7/01. mart 2019. godine), na osnovu Zakona o Budžetskim Izdvajanjima za Budžet Republike Kosova za 2023. godinu, kao i člana 12. Uredbe MF 04/2017 o Kriterijumima, Standardima i Procedurama za Finansiranje NVO-a, Generalne Sekretarke, donosi:

ODLUKU

Javni poziv za javnu finansijsku podršku projektima NVO-a licenciranim u oblasti socijalnih i porodičnih usluga

1. Ovlašćuje se objavljivanje javnog poziva za pružanje javne finansijske podrške projektima NVO-a licenciranim u oblasti socijalnih i porodičnih usluga.
2. Javni poziv iz tačke 1. ove odluke vrši se u skladu sa odredbama Uredbe MF 04/2017, odredbama o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO-a.
3. Javna finansijska podrška projektima NVO-a biće obezbeđena iz budžeta Ministarstva Pravde, ekonomski kod 21200, kategorije rashoda, subvencija i transfera u okviru budžetskog potprograma 01500.
4. Sredstva definisana u tački 3. ove odluke biće raspodeljena na osnovu javnog poziva za finansiranje projekata NVO-a i odgovarajuće dokumentacije za sprovođenje poziva.
5. Potrebna relevantna dokumentacija i kriterijumi za apliciranje za javnu finansijsku podršku za projekte NVO-a licenciranim u oblasti socijalnih i porodičnih usluga biće objavljeni na zvaničnoj internet stranici Ministarstva pravde (<https://md.rks-gov.net>).

6. U skladu sa Uredbom MF 04/2017 o kriterijumima, standardima i postupcima javnog finansiranja za NVO i uputstvima za aplikante, Ministarstvo pravde formiraće Komisiju za Procenu, za otvaranje i registraciju prijava kao i verifikaciju definisanih uslova javnog poziva.
7. Komisija za procenu će proceniti sadržaj prijava prihvaćenih projekata koji su uspešno, ili ne, ispunjavali uslove da budu deo konkursa u skladu sa zakonodavstvom na snazi.
8. Članovi Komisije za procenu imaju pravo na naknadu za rad u komisiji u skladu sa važećim zakonodavstvom za prekovremeni rad.
9. Glavni administrativni službenik donosi odluku o dodeli sredstava za finansiranje projekata NVO-a nakon prihvatanja odluke Komisije za procenu o uspešnim kandidatima.
10. Ministarstvo pravde će obavestiti korisnike o vremenu potpisivanja ugovora i izvršiće prenos finansijskih sredstava korisnicima / NVO-a.
11. Odgovorna za sprovođenje ove odluke je nadležna jedinica koja pokriva oblasti po javnom pozivu koji je raspisalo Ministarstvo pravde.
12. Odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Anita Kalanderi

Generalna Sekretarka

Odluka se dostavlja:

- *Kabinetu Ministarke Pravde;*
- *Kancelariji Generalnog Sekretara;*
- *Diviziju za Socijalne Usluge;*
- *Diviziji za Budžet i Finansije;*
- *Arhivi Ministarstva Pravde.*